VENDIM
Nr. 274, datë 28.12.2020

MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SEKRETARIATIT TË KOMUNITETIT TË ENERGJISË, NË LIDHJE ME SHTIMIN E SHTOJCËS E, NË RREGULLAT E PËRKOHSHME PËR MEKANIZMIN BALANCUES TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUARA ME VENDIMIN E BORDIT NR. 193, DATË 24.11.2017

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, germa "gj", nenit 62, nenit 76, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, si dhe neneve 15 dhe 26, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 142/17 prot., datë 24.12.2020, të drejtorive teknike,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 193, datë 24.11.2017, Bordi i ERE-s miratoi "Rregullat e përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike".

- Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, me shkresën nr. 23/157 prot., datë 22.10.2019, ka ftuar ERE-n të nisë procedurën për amendimin e "Rregullave të përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike", duke përfshirë në këtë dokument edhe shtojcën E, të përgatitur dhe të propozuar nga Sekretariati.

- Ndryshimet e propozuara nga Sekretariati adresojnë trajtimin e problematikës së ngritur nga HEC "Ashta" për trajtimin e disbalancave. HEC "Ashta" ka parashtruar pretendimin se ka konstatuar devijime midis informacionit të një dite më parë dhe shkarkimit aktual të ujit realizuar nga HEC "Vau i Dejës", duke rezultuar kjo në krijimin e devijimeve të cilat shkaktohen nga pjesëmarrës të tjerë të tregut të energjisë elektrike dhe jo nga vetë subjekti HEC "Ashta".

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 21, datë 31.1.2020, vendosi: "Fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së Sekretariatit të Energjisë në lidhje me shtimin e shtojcës E në "Rregullat e përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike", të miratuara me vendimin e Bordit nr. 193, datë 24.11.2017".

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 106, datë 2.7.2020, vendosi miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike.

- Mbështetur në pikën 5 të vendimit të lartpërmendur, e cila parashikon detyrimin për raportim dhe dokumentim çdo muaj nga ana e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.), në lidhje me ecurinë e zbatimit të tyre, OST sh.a. ka raportuar në mënyre periodike në ERE lidhur me ecurinë e zbatimit të fazës *Dry Run* (pa efekte financiare) të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike.

- Raportet janë përcjellë në ERE nëpërmjet shkresave me nr. 5263 prot., datë 3.9.2020 dhe nr. 6006 prot., datë 9.10.2020, por edhe në adresën zyrtare të e-mail-it të ERE-s, erealb@ere.gov.al, ndërkohë që me shkresën nr. 7186 prot., datë 27.11.2020 në ERE është përcjellë Raporti i Vlerësimit.

- Nga informacioni i evidentuar në raportet e dërguara nga OST sh.a., rezultoi se përgjatë periudhës *DRY Run* të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike nuk u konstatua asnjë raportim problematik lidhur me sa parashtruar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë për trajtimin e problemeve të ngritura nga HEC "Ashta", që lidhen me disbalancat.

- Si dhe lartpërmendur, Bordi i ERE-s vendosi miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike përmes vendimit nr. 106, datë 2.7.2020, hyrja në fuqi me efekte financiare e të cilave shfuqizon "Rregullat e Përkohshme për Mekanizimin Balancues të Energjisë

Elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr.193, datë 24.11.2017, parashikimi ky i përcaktuar në pikën 4, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 106/2020.

Sa parashtruar më sipër, shtimi i shtojcës E, propozuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, në Rregullat e Përkohshme për Mekanizmin Balancues të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017, me shfuqizimin e tyre, si parashikuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020, do të bënte që ky ndryshim të ishte pa efekte juridike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos miratojë kërkesën e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë në lidhje me shtimin e shtojcës E në Rregullat e Përkohshme për Mekanizmin Balancues të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti